REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 65 prot. **Kamëz, më 21.9.2026**

V E N D I M
Nr.70 .Datë 21/9 2026
MBI
"MIRATIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE TË DESTINUARA PËR PARKIM ME PAGESË DHE KRITEREVE TË ADMINISTRIMIT TË TYRE NË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ"

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.09.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.65 Datë 17.09.2026 në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000, "Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz nr. 89, datë 17.12.2025 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz", Urdhërin e Brendshëm nr. 9001.,prot datë 31.08.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në territorin e bashkisë Kamëz", **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapësirave publike të destinuara për parkim me pagesë, sipas listës së mëposhtme të detajuar në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi (Trarët elektrikë).

2. Përcaktimin e niveleve të tarifave, fashave orare dhe ditëve të tarifimit për shërbimin e parkimit me pagesë në hapsirën publike, do të jetë sipas parashikimeve të Paketës Fiskale të Bashkisë Kamëz.

3. Të ngarkojë Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Kamëz, për vjeljen e tarifave të shërbimit të parkimit publik me pagesë në zonat e përcaktuara në anekset bashkëlidhur, për llogari të Bashkisë Kamëz, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Drejtoria e Licensave dhe Trasnportit, si dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit.

5. Bashkëlidhur relacioni shpjegues i vendimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI